

Shtojca nr. 1

PLANI I MASAVE PËR SEZONIN TURISTIK VEROR 2024

NR.	INSTITUCIONET	DETYRAT	INSTITUCIONE BASHKËPUNUESE
		Të ndihmojë për sa është e mundur dhe të monitorojë grumbullimin dhe largimin e mbetjeve nga zonat turistike drejt vendeve të depozitimit të paracaktuara, duke koordinuar me Njësitë e Vetëqeverisjeve Vendore për monitorimin e shërbimit të pastrimit, largimit të mbetjeve dhe monitorimit të pastërtisë së stacioneve të plazhit, në zonat bregdetare dhe brigjet e liqenit.	Agjencia Kombëtare e Mjedisit Agjencia Kombëtare e Bregdetit Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore Agjencia Kombëtare e Turizmit Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura Prefekturat
		AKZM/ADZM synojnë realizimin e objektivave për sezonin turistik 2024 si më poshtë: • Konservimi dhe mbrojtja e burimeve natyrore në territorin e zonave të mbrojtura, ku ekosistemet do të ofrojnë shërbimet e tyre për vizitorët; • Vënien në rolin e guidës së stafit të zonave të mbrojtura në shtigjet e markuara; • Funksionimin e qendrave ekzistuese të informacionit të mëposhtëm, përmes bashkërendimit të punës me pushtetin vendor. Menaxhimi i vizitorëve në çdo stinë të vitit dhe ofrimi i informacionit të nevojshëm përmes hartave, fletëpalosjeve, etj. ; • Informim dhe promovim nëpërmjet faqes web AKZM.gov.al	Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura
		Të realizojë takime me Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore në zonat bregdetare dhe liqenore për zbatimin e planit të masave për mbarëvajtjen e sezonit turistik veror 2024. Pjesëmarrje dhe bashkëpunim me Komitetet Rajonale të Turizmit, si detyrim institucional, bazuar në ligjin me Nr. 93/2015 "Për Turizmin", i ndryshuar, nën drejtimin e prefekturave.	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore Prefektura Agjencia Kombëtare e Bregdetit
		Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve ti vendoset në dispozicion, në fillim të sezonit turistik, lista e strukturave të certifikuara akomoduese dhe kontratave të lidhura për stacionet e plazhit.	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit Agjencia Kombëtare e Bregdetit
		Ushtrimi i kontrollit dhe inspektimit në të gjitha stacionet e plazhit në vijën bregdetare, për përmbushjen e kriterëve dhe standarteve në bazë të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 171, datë 27.03.2019 Për miratimin e rregullores "Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit", i ndryshuar, si dhe inspektimi i të gjitha veprimtarive turistike në Republikën e Shqipërisë, në zbatim të ligjit nr. 93/2015 "Për Turizmin", i ndryshuar.	Agjencia Kombëtare e Bregdetit
		Ndjekja e procesit të aplikimeve për stacione sezonale ankorimi/bregëzimi, sipas parashikimeve të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 29.4.2022 "Për kriteret e vendosjes dhe të funksionimit të stacioneve sezonale të ankorimit/bregëzimit".	Agjencia Kombëtare e Bregdetit
		Ndjekja e procesit të pastrimit të zonës bregdetare nga operatori ekonomik i kontraktuar për realizimin e këtij shërbimi, për periudhën 15 Qershor -15 Shtator 2022, për Bashkitë Durrës, Kavajë, Himarë, Sarandë, Rrogzhinë, Vlorë, Lezhë në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 891, datë 27.12.2022 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 569, datë 17.07.2019 "Për krijimin dhe mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit", i ndryshuar.	Agjencia Kombëtare e Bregdetit
		Përgatitja e kontratave për përdorimin e hapësirës së plazhit, për subjektet aplikues për sezonin turistik veror 2024, pas miratimit të tyre nga Grupi Teknik I Shqyrtimit të Aplikimeve, me palë përfituese Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore	Agjencia Kombëtare e Bregdetit

**MINISTRIA E
TURIZMIT DHE
MJEDISIT**

Takime me njësitë vendore, prefekturat dhe institucionet kompetente për zbatimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 171, datë 27.03.2019 "Për miratimin e rregullores "Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit", I ndryshaur, si dhe diskutimin e planit të masave për mbarëvajtjen e sezonit turistik veror 2024.	Agjencia Kombëtare e Bregdetit
Verifikimi I masave të sigurisë së pushuesve (rojet e plazhit, sipas kriterëve të përcaktuara, vendosja e sinjalistikës, bovat)	Agjencia Kombëtare e Bregdetit
Bashkëpunimi me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit dhe Njwsitë e Pushtetit Vendor, për përcaktimin e korridoreve të hyrje-daljeve dhe përgatitja e hartës përkatëse për plazhet.	Agjencia Kombëtare e Bregdetit Ministria e Turizmit dhe Mjedisit Njësitë e Pushtetit Vendor
Të hartohen dhe zbatohen planet për evidentimin dhe menaxhimin e mbetjeve urbane të ngurta dhe mbetje të tjera me impakt negativ në mjedis, përgjatë akseve kombëtare dhe atyre që të çojnë në destinacionet turistike.	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit përmes Agjencisë Kombëtare të Bregdetit Agjencia Kombëtare e Mjedisit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë edhe nëpërmjet Autoritetit Rrugor Shqiptar Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore Prefektura
Të kontrollohen shkarkimet e ujërave të përdorura në zonat e pushimit dhe të plazheve.	Agjencia Kombëtare e Mjedisit
Ngritja e grupeve të punës për monitorimin, verifikimin dhe evidentimin në nivel qendror, në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit dhe në nivel rajonal, në Agjencitë Rajonale të Mjedisit, për zbatimin e kërkesave ligjore e nënligjore, mbi parandalimin e shkarkimeve të ujërave të patrajtuara në mjedisin ujor, detar, liqenor, veprimtari të ndaluara në brigje e plazhe dhe shfrytëzimi i inerteve lumore me leje të përdorimit ujor;	Agjencia Kombëtare e Mjedisit
Evidentimi I të gjithë subjekteve që gjenerojnë ujëra të ndotura në vijën bregdetare e liqenore dhe inspektimin e tyre, lidhur me zbatimin e kërkesave ligjore e nënligjore, për trajtimin e ujërave të ndotura në impiantet përkatëse, largimin e tyre në kolektorët e Ujësijellës Kanalizimeve apo me subjekte të licensuara dhe kontraktuara nga ana e tyre, sipas legjislacionit në fuqi;	Agjencia Kombëtare e Mjedisit
Të publikohen të dhënat për strukturat akomoduese (kontakte, kapacitete, vendndodhje e shërbime), agjencitë turistike dhe për subjekte të tjera turistike, në faqen zyrtare të MTM-së sipas shpërndarjes gjeografike dhe destinacionit turistik.	Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore Agjencia Kombëtare e Turizmit Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
Të hartohen dhe miratohen me Vendim të Këshillit Bashkiak nga Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, planet lokale të zhurmave. Të zbatohet programi i kontrollit, për matjet për nivelin e zhurmës në destinacionet turistike nga struktura përgjegjëse inspektuese në fushën e mjedisit dhe struktura përgjegjëse në Njësinë e Vetëqeverisjes Vendore.	Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore Agjencia Kombëtare e Mjedisit Prefektura Policia e Shtetit
Të planifikojë, orientojë, koordinojë Kalendarin Kombëtar të ngjarjeve kulturore të traditës sportive dhe natyrore që ofrojnë zbavitje dhe kënaqësi për turistët në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, në bashkëpunim me Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit dhe institucionet e saj, institucione të tjera qendrore dhe lokale, publike e private, shoqata e organizata, etj. Të promovojë Kalendarin Kombëtar të Eventeve dhe aplikacionin TEA.	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit/Agjencia Kombëtare e Turizmit Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore Prefektura
Të verifikojë masat e sigurisë së pushuesve (Rojet e Plazhit sipas kriterëve të përcaktuara, vendosja e sinjalistikës, bovat, etj).	Agjencia Kombëtare e Bregdetit Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore

		Të përmirësojë rrjetin e informacionit turistik dhe pajisjen në vazhdimësi me materiale promovuese të standave promovuese të ngritura në pikat kufitare dhe në ambasadat Shqiptare jashtë vendit.	Agjencia Kombëtare e Turizmit Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
2	MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË	Të merren masa për evitimin gjatë sezonit veror të rrugëve në ndërtim dhe të realizohen me prioritet investimet për rikonstruksionin, mirëmbajtjen dhe pajisjen me sinjalistikë rrugore të rrugëve drejt destinacioneve turistike dhe natyrore.	Autoriteti Rrugor Shqiptar Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
		Të hartohet një plan masash për oraret e kufizuara të lëvizjes së mjeteve në rrugët kombëtare gjatë sezonit turistik veror	Autoriteti Rrugor Shqiptar Ministria e Brendshme
		Në portet Detare: a. Të përcaktohen kalata të veçanta për anijet turistike në portet e Durrësit, Vlorës, Sarandës dhe Shëngjinit; b. Të vendosen sinjalistikat horizontale dhe vertikale, vijëzimet në rrugë dhe ndriçimi i nevojshëm për të orientuar lëvizjen e sigurtë të turistëve nga terminali deri në dalje; c. Të vendosen rrethime për kufizimin e lëvizjeve pranë kalatave; d. Të caktohen ambiente shtesë për parkimin e automjeteve që hyjnë e dalin në port; e. Të bëhet shtimi i sporteve dhe personelit të Sigurisë Portuale në terren për periudhën e fluksit si dhe trajnimi i tyre; ë. Të shtohen stacionet sezonale të ankorimit të mjeteve lundruese për turizëm.	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë Ministria e Brendshme
		Të bashkëpunojë me MTM dhe Njësitë e Pushtetit Vendor, për përcaktimin e zonave për ankorimin e mjeteve lundruese argëtuese, korridoret e hyrje daljeve dhe përgatitja e hartës përkatëse për plazhet në zbatim të VKM Nr. 321 "Për sigurinë në det, plazhe, në ujërat e brendshme në thellësi të territorit dhe gjatë ushtrimit të sporteve ujore". Pajisja e korridoreve të hyrje daljeve të mjeteve lundruese argëtuese me sinjalistikën përkatëse.	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë - Drejtoria e Përgjithshme Detare Agjencia Kombëtare e Bregdetit Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore Prefektura
		Të sigurohet furnizim pa ndërprerje me energji elektrike, të merren masa të shtuara për rregullimin në kohë sa më të shkurtër të rast të ndërprerjeve të energjisë elektrike në zonat turistike.	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë - Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike
		Përditësimi i listës së mjeteve turistike sipas shoqërive të licencuara dhe pasqyrimi në faqen e Ministrisë.	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit
		Përditësimi i informacionit mbi oraret dhe stacionet e autobusëve, për linjat ndërqytetase në të gjithë vendin dhe pasqyrimi i këtij informacioni në faqet publike të institucioneve.	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit
		Zbatimi i parimeve të planifikimit të zhvillimit të turizmit, në përputhje me Planin e Përgjithshëm Kombëtar, procedurën e caktimit të zonave me përparësi zhvillimin e turizmit, përgatitjen dhe përmbajtjen e planit kombëtar sektorial të turizmit si dhe procedurën e hartimit të planit të zonave me përparësi zhvillimin e turizmit.	Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit
		Marrja e masave për respektimin e kriterëve në zbatim të ligjit me Nr.8308, datë 18.3.1998 "Për Transportet Rrugore", i ndryshuar.	Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor
		Përditësimi i hartës së aksidenteve rrugore (hot spot), publikimi dhe vënia në dispozicion agjencive turistike.	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë Ministria e Brendshme
Të merren masa, për përpunimin e të dhënave në çdo kohë të mjeteve lundruese turistike, jahte, veljera etj.	Drejtoria e Përgjithshme Detare Ministria e Turizmit dhe Mjedisit		
3	MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL	Marrja e masave për pastrimin dhe mirëmbajtjen e kanaleve kryesore kullues në zonat bregdetare nëpërmjet 4 Drejtorive Rajonale të Ujitjes dhe Kullimit Lezhë, Fier, Durrës dhe Korçë.	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
		Marrja e masave për inspektimin e subjekteve që prodhojnë, përpunojnë dhe tregtojnë produkte ushqimore për garantimin e sigurisë ushqimore dhe mbrojtjen e konsumatorit.	Autoriteti Kombëtar i Ushqimit
		Hartimi dhe zbatimi i një plani masash për garantimin e sigurisë publike në destinacionet turistike gjatë sezonit turistik veror 2024.	Policia e Shtetit
		Zbatimi i legjisllacionit që sanksionon krimin mjedisor si krim penal, me fokus të shtuar zonat turistike.	Policia e Shtetit

4	MINISTRIA E BRENDSHME MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË MINISTRIA E MBROTJES	Krijimi dhe funksionimi i "Njësisë Policore Detare", e cila do të ketë për objekt dhe detyrë monitorimin e hapësirës bregdetare shqiptare, kontrollin e mjeteve lundruese turistike dhe të argëtimit me një flotë mjeteve lundruese të tipit "Jet - Ski" (motorë uji) dhe efektiv punonjësish policie të trajnuar dhe certifikuar për shërbime të tilla në det dhe liqene, si edhe rritjen e sigurisë në hapësirën ujore.	Policia e Shtetit
		Të bashkërendohet puna për vendosjen e sinjalistikës horizontale dhe vertikale, vijëzimet në rrugë dhe ndricimi i nevojshëm për të orientuar levizjen e sigurtë të turistëve nga terminali deri në dalje në bashkëpunim me Autoritetet Portuale dhe MIE.	Policia e Shtetit Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
		Të ushtrohen kontrole nëse mjetet e transportit të turistëve kanë lidhur kontratë me operatorin/agjencinë turistike, emri i së cilës duhet të jetë i ekspozuar dukshëm.	Policia e Shtetit
		Saktësimi i numrave të emergjencës për pushuesit duke shtuar postat e policisë/ personelit në zonat e frekuentuara gjatë sezonit turistik.	Ministria e Brendshme
5	MINISTRIA PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME	Krijimi i lehtësirave të hyrje – daljeve në Pikat Kombëtare të Kufirit për grupet e turistëve.	Policia e Shtetit
		Promovimi i Shqipërisë nëpërmjet rrjetit të përfaqësive diplomatike.	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit
6	MINISTRIA E MBROJTJES	Angazhimi i FARSH, në përputhje me Planin Kombëtar të Emergjencave Civile gjatë sezonit turistik.	Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile Ministria e Turizmit dhe Mjedisit Prefektura Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore
		Nënshkrimi i marrëveshjes së bashkëpunimit mes Ministrisë së Mbrojtjes dhe Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit për ishullin e Sazanit në funksion të vizitave turistike.	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në bashkëpunim me Ministrinë e Mbrojtjes
		Monitorimi dhe trajtimi i mbetjeve nga zonat turistike drejt vendeve të depozitimit të paracaktuara, në ishullin e Sazanit	Ministria e Mbrojtjes në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Bregdetit
7	MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE	Të rrisë prezencën në territor dhe efikasitetin e shërbimit ambulator, të urgjencës mjekësore në të gjitha destinacionet turistike me fluks të shtuar të vizitorëve.	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Inspektoriati Shtetëror Shëndetësor
		Të bëhen inspektime dhe kontrole për respektimin e normave dhe rregullave higjieno - sanitare në objektet turistike, restorante e struktura akomoduese, subjektet e furnizimit me ujë të pijshëm, pishinat, subjektet e shërbimit ambulator të hapura në të gjitha destinacionet turistike, subjektet social kulturore dhe sportive	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Inspektoriati Shtetëror Shëndetësor
		Të kryhen analizat e ujërave të detit dhe të rritet numri i stacioneve të monitorimit. Identifikimi i burimeve direkte dhe indirekte të ndotjes së plazheve. Të publikohen rezultatet.	Agjencia Kombëtare e Mjedisit Inspektoriati Shtetëror Shëndetësor
		Kryerja e inspektimeve përgjatë gjithë vijës bregdetare në: •Subjektet të cilat janë të lidhura me rrjetin e kanalizimeve të ndërmarrjeve të UK; •Subjektet që i derdhin ujërat e zeza në gropa septike, për evidentimin e kontratave me subjekte shtetërore ose private (bote).	Inspektoriati Shtetëror Shëndetësor
		Organizimi i shërbimit shëndetësor në qendrat shëndetësore që do të funksionojnë pranë zonave turistike të vendit gjatë sezonit veror. (identifikimi i strukturave që do të shërbejnë si qendra shëndetësore verore, vendosja e sinjalistikës, paisja e tyre me paisjet e nevojshme.	Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore
		Ofrimi i shërbimeve të kujdesit shëndetësor sipas një liste të përcaktuar shërbimesh për qytetarët që paraqiten pranë këtyre qendrave.	Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor
		Trajnimi i stafëve mjekësore që do të ofrojnë shërbim shëndetësor në qendrat shëndetësore që do të funksionojnë pranë zonave turistike të vendit gjatë sezonit veror.	Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore
Garantimin e shërbimit falas nga urgjenca mjekësore në kohën e duhur për shtetasit që konsiderohen në gjendje rrezikshmërie të lartë për jetën, sipas protokolleve të miratuara nga ministri përgjegjës për shëndetësinë.	Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore		

		Ofrimi i shërbimit të urgjencës mjekësore në të gjitha nivelet e tij, për të gjithë shtetasit shqiptarë dhe të huaj me banim të përhershëm ose të përkohshëm në Shqipëri, si dhe për çdo shtetas të huaj që është duke kaluar në territorin e Shqipërisë.	Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore
		Barazi në përfitimin e shërbimit të urgjencës mjekësore pa asnjë diskriminim; ndërthurja e veprimeve të urgjencës mjekësore me të gjitha emergjencat kombëtare (zjarrfikës, polici).	Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore
		Vënia në gatishmëri e qendrës së shërbimit të helikopterëve të Ministrisë së Shëndetësisë për asistencën mjekësore dhe transportin e rasteve urgjente.	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
		Dezinfektimi i zonave bregdetare, ligatinore dhe qyteteve bregdetare, përpara fillimit të sezonit veror. (MSHMS) Kontributi në fushatat dhe aksionet e pastrimit të zonave turistike.	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit Prefektura Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore
8	MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT	Udhëzimin e Ministrisë të Kulturës tashmë me menyrën e funksionimit dhe përgjegjësitë e institucioneve të trashëgimisë kulturore dhe muzeve gjatë sezonit turistik i cili parashikon masat për: <ul style="list-style-type: none"> • Zgjatjen e orareve të funksionimit të institucioneve dhe hapja për publikun çdo ditë të javës; • Pajisja me bileta elektronike, online dhe manuale përkundrejt çdo vizitori; • Pajisjen me faturën tatimore për Agjencitë Turistike dhe jo vetëm përkundrejt shërbimit të kërkuar; • Pajisja me uniforma me logon e MK dhe institucionit përfaqësues; • Marrja e masave për prezantimin online në faqet zyrtare; web dhe rjetet sociale të gjithë veprimtarisë dhe aktivisteve kulturore përgjatë sezonit tek institucionet kulturore; • Paraqitja e kalendarit të aktiviteteve në nivel kombëtar në faqen zyrtare të MK dhe institucioneve ku do të zhvillohen; • Ngritjen e stekuarave të monitorimit përgjatë sezonit; • Raportimin në kohë reale të çdo problematike të hasur gjatë orarit të funksionimit; Koordinimin me cicërohet dhe udhëdhëftuesit turistik ku ato janë të certifikuar dhe ku grupet e turistëve e kërkojnë këtë shërbim nga institucionet e trashëgimisë dhe muzeve; <ul style="list-style-type: none"> • Publikimin në faqen zyrtare të MK të këtij kalendar. 	Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit
		Hartimin e kalendarit të aktiviteteve kulturore pjesë e kalendarit të projekteve kulturore të mbështetura nga MK për vitin 2024 (me thirrje dhe jo vetëm) Kalendarin e aktiviteteve "Javët Kulturore Ndërkombëtare"	Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit
		Zhvendosja e aktiviteteve kulturore në kohën e sezonit dhe në zonat bregdetare (ekspozita, panairë të ndryshme, produkte artizanale, etj.).	Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
		Publikimi i bazës së të dhënave të muzeve, monumenteve të kulturës, parqeve arkeologjike, në faqen zyrtare të Ministrisë me oraret dhe kontaktet përkatëse.	Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit
9	MINISTRIA E FINANCAVE	Kontrolli i subjekteve tregtare në destinacionet turistike për ekspozimin e çmimeve për produktet/shërbimet e ofruara, në vende të dukshme për publikun.	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
		Kontrolli i subjekteve tregtare për zbatimin e procedurës së fiskalizimit.	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
		Kontrolli i subjekteve tregtare në destinacionet turistike për lëshimin e faturës tatimore.	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
		Kontrolli i tatimpaguesve nëse janë rregjistruar në përgjegjësitë përkatëse tatimore.	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
		Verifikimi i deklarimit të punonjësve dhe pagave në organin tatimor.	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
		Shtim I kontrollove të zinxhirit furnizues të turizmit	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
		Verifikimi i subjekteve tregtare që operojnë nëpërmjet platformave online për shtimin e deklarimeve dhe minimizimin e subjekteve të paregjistruara	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
		Bashkërendimi me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit për zbatimin me korrektësi të nenit 49 të Ligjit nr. 92/2014 "Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë"	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve Ministria e Turizmit dhe Mjedisit

		Ushtrimin e kontrollit në subjekte që ushtrojnë aktivitet gjatë sezonit turistik, me synim minimizimin e punës informale, punës jashtë rregullave të sigurisë dhe shëndetin në punë, funksionimit të marrëdhënieve të punës në drejtim të kohëzgjatjes së punës, punës së kryer në turnin e dytë dhe të tretë, në ditët e pushimit javor, festave, etj.	Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore
		Në fokus të veçantë të këtyre inspektimeve është punësimi i punëmarrësve nën 18 vjeç, i të huajve dhe vrotuesve të plazhit në stacionet e plazhit, në lidhje me punësimin e tyre.	Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore
		Ushtrim i kontrolleve në stacionet e plazhit për dokumentacionin ligjor (kontrata e lidhur duhet të jetë e regjistruar në organet tatimore).	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
10	NJËSITË E VETËQEVERISJES VENDORE	Zhvillimi i stacioneve të plazhit publik me standarte dhe kushtet higjieno - sanitare sipas destinacioneve dhe tipologjive.	Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore
		Sigurimi i sinjalistikës së nevojshme në plazhe (rërë dhe ujë) për saktësimin e plazheve të menaxhuara dhe publike, si dhe për zonat ujore të lejuara dhe ato me rrezikshmëri.	Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore
		Të merren masa për mirëmbajtjen e rrugëve të brendshme (vijëzimi i rrugëve, vendosja e sinjalistikës dhe informacion në lidhje me shërbimet bazë: polici, spitale, plazhe, pika të vizitueshme), rrugëve që çojnë drejt destinacioneve turistike dhe ndriçimin e tyre.	Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore
		Të zbatohen planet për menaxhimin e mbetjeve urbane, shtimi i kontinerëve dhe hartimin e planeve të qarta, me fasha orari të përshtatshme për largimin e mbetjeve urbane në të gjithë destinacionet turistike.	Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore
		Të përcaktojnë vendparkimet e automjeteve në zonat e plazheve.	Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit
		Të hapen dhe të vihen në funksion të plotë zyrat e informimit për turistët në qendrat e qyteteve dhe në afërsi të pikave turistike.	Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore
		Të vihen në dispozicion të pushuesve numra telefoni pranë Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore për ankesat apo shërbimet e munguara ndaj tyre.	Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore
		Të merren masa për furnizimin pa ndërprerje me ujë si dhe sistemimin e rrjetit të kanalizimeve të ujërave e bardha dhe të zeza, veçanërisht në destinacionet turistike. Të përgatitet plani i koordinimit për ta patur nën kontroll situatën për çdo defekt të mundshëm gjatë gjithë sezonit turistik.	Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore Prefektura
		Hartimi i kalendarit të Festave Lokale 2024 nga çdo bashki. Organizimi dhe mbarëvajtja e tyre si mundësi e mirë për provimin e atraksioneve turistike të zonës si edhe prodhimeve tradicionale dhe karakteristike të zonës.	Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore
		Të hartojë një plan të qartë të depozitimit të mbetjeve nga subjektet turistike, me orare dhe vende të përcaktuara, të monitorojë grumbullimin e mbetjeve deri në largimin e tyre drejt vend - depozitimeve të përcaktuara.	Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore Prefektura
11	PREFEKTURAT	Koordinimi ndërinstytucional përmes Komiteteve Rajonale të Turizmit, të institucioneve lokale për mbarëvajtjen e sezonit turistik.	Prefekturat Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore
		Monitorim i pastrimeve frekvente në zonat turistike, organizim i aksioneve për pastrimin të territoreve të zonave turistike, veçanërisht në kohën e flukseve të larta të vizitorëve.	Prefekturat Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore
		Në kuadër të menaxhimit dhe mbarëvajtjes së sezonit turistik veror, Prefektët e Qarqeve me urdhër ngrejné Task-Forcën, e cila do të ndjekë zbatimin e masave në nivel qarku dhe raportojné në Ministrinë e Brendshme mbi zbatimin e detyrave dhe masave të institucioneve pjesë të Task-Forcës dhe Njësitë të Vetëqeverisjes që ka secila prefekturë nën juridiksionin e saj.	Prefekturat